

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/109-dite-revolte-kunder-qeverise-qytetaret-nuk-e-ndalin-rezistencen-i514308
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:56:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:51:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cc876478798beb82f40016985f790c93a85795c911789bfff276b8a7a5bbe3a0b
TEKSTI	db9d77e06258123da81e34dc2d4dc1167a4fc813383b2f420d1b001c5fdbbc484
PAMJA	3b5995d338c106d92988f43a7dead803cb2c1e04557a0d083b66a1017e5a8868

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	89c5693f30ed7ba20765a50fc6f8e2f99bdfc595a039f1c97e4c8ac55c13cf71
E MËPARSHMJA	5f8eec39d05bb4804432d3e767c375523038a1c2e798d9a9291f43888b9c6a2f
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/89c5693f30ed7ba20765a50fc6f8e2f99bdfc595a039f1c97e4c8ac55c13cf71>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

4 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

6 ORE ME PARE

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

8 ORE ME PARE

SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Po punojmë për shkatërruar organizatat kriminale. Kosovë- Serbi të shmangin provokimet

10 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ Seanca dëgjimore me institucionet e drejtësisë në komisionin e Ligjeve, KLP e GJL kundër formulës së PS: Rritje minimale

LIVE UPDATES

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

• Protestuesit janë mbledhur sot në protestën e 108-të radhazi për largimin e Kryeministrit Edi Rama. • Fillimisht qytetarët janë mbledhur në Sheshin "Skënderbej" dhe më pas kanë marshuar drejt kryeministrit, aty ku dhe kanë mbajtur fjalimet e tyre. • Protestuesit kërkojnë ndryshim të gjithë klasës politike, mesazh të cilën e kanë përcjellë prej 108 ditësh me thirrjen "Rama në burg, Berisha në burg". • Pavarësisht 108 ditëve të protestave, protestuesit deklarojnë se nuk do të tërhiqen dhe se do të vijojnë qëndresën deri në realizimin e kërkesave të tyre. • Gjatë fjalimeve, Anëtarja e Dhomës Britanike të Tregtisë dhe një nga aktivistet pjesëmarrëse në protestë, deklaroi se bujqësia ndodhet në gjendje të rëndë për shkak të politikave të ndërrmarra nga qeveria e Edi Ramës. • Ajo theksoi se prej tre vitesh ky sektor nuk ka marrë asnjë ndihmë, pas ndaljes së fondeve nga BE për shkak të vjedhjeve të kryera. • Sipas saj, fermerët u detyruan t'i hidhnin produktet e tyre nëpër kanale, sepse kryeministri lejoi produktet e Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut përmes Ballkanit të Hapur. • Pas përfundimit të fjalimeve para Kryeministrit, qytetarët kanë vijuar marshimin rrugëve të kryeqytetit. • "Arrestoni Ramën", "O Ergys o legen prite Ramën se po vjen", "Edi Rama frikacak", "Dorëheqje, ju erdhi fundi", "Policia e krimit", "Edi Rama jep dorëheqjen", "Edi Rama në burg", "O Erion o legen prite Ramën se po vjen", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët" dhe "Shqipëria kërkon revolucion", janë disa nga thirrjet kryesore që protestuesit kanë brohoritur në kor gjatë tubimit.

9 artikuj për këtë temë.

3 ORE ME PARE

Mbyllet protesta e 108-të, protestuesit thirrje: Nesër më shumë



Pamje nga protesta

TIRANË- Protestuesit kanë mbyllur ditën e 108-të të revoltës qytetare me thirrjet "Nesër më shumë". Pas marshimit në rrugët e Tiranës, dhe qëndresës në formë mbështetje për protestuesit e arrestuar në Bllokun e Sigurisë protestuesit janë shpërndarë.

Protestuesit kanë paralajmëruar tubim ditën e enjte përballë Kuvendit, ndërsa kërkesat e tyre mbeten të njejtat./Dosja.al

3 ORE ME PARE

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 15 SHTATOR 2026, 15:01

"Nuk mund të orientoni fjalët e mia"/ Gjyqtari Gerd Hoxha përplasat me Ulsi Manjën, deputeti socialist acarohet: Fikeni mikrofonin, ne jemi sovrani (VIDEO)

Marshimi i protestuesve/ Qëndres te Blloku i Sigurisë për të ndaluarit: Nuk jeni vetëm



Pamje nga qendresa te Blloku i Sigurisë

TIRANË- Protestuesit kanë mbërritur te Blloku i Sigurisë gjatë marshimit në ditën e 108-të të revoltës qytetare. Nën thirrjet "Nuk jeni vetëm", "Lironi shqipet", "Gjithë Shqipëria është me ju", ata kanë vijuar qëndresën e tyre te Blloku i sigorisë në formë mbështetjeje për protestuesit e arrestuar.

Kërkesat e qytetarëve mbeten dorëheqja e panegociueshme e kryeministrit të vendit Edi Rama, si dhe anulimi i ligjit për zonat e mbrojtura./Dosja.al

4 ORE ME PARE

“Bujqësia në kushte skandaloze”, protestuesja: Paratë e BE-së grabiten nga njerëzit e Ramës, janë hajdutë të pangopur



Silvana Hoxha Xhaferri

TIRANË- Anëtarja e Dhomës Britanike të Tregtisë dhe aktivistja Silvana Hoxha Xhaferri gjatë fjalës së saj në protestën e sotme, deklaroi se bujqësia në Shqipëri ndodhet në një gjendje të rëndë, duke ia lënë fajin situatës së politikave. Sipas saj, sektori nuk ka marrë mbështetje prej tre vitesh, ndërsa fondet e Bashkimit Evropian janë ndërprerë dhe me to është abuzuar.

Xhaferri tha gjithashtu se fermerët janë përballur me vështirësi të mëdha në shitjen e prodhimeve të tyre, deri në detyrimin për ti hedhur ato në kanale. Ajo e lidhi situatën me lejimin e hyrjes së produkteve nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut në tregun shqiptar, përmes nismës së Ballkanit të Hapur.



AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 19:26

FOTOLAJM/ Kosova ‘vishet’ me flamuj e portrete para aktgjykimit në Hagë: Çlirimtarë, sillni në shtëpi

POLITIKE 15 SHTATOR 2026, 18:15

Kongresmeni Wilson: Qeveria e Ramës po nxit trafikun e narkotikëve. Zv/ndihmës Sekretari Lawton: Organizatat kriminale kanë lidhje me kartelet këtu në SHBA

më të klikuarat



SKANDAL/ Deputetja Zegjine Çausi ishte në djepin e dajës së saj dhe kishte marrë peng dhe përdhunuar të renë. Viktima: Erdhi në shtëpi, tha se do na fus në telashe

Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

Trafikonin sasi të mëdha kokaine/ Goditet banda shqiptare në Belgjikë, arrestohet dhe Gert Gjenerali

Rishfaqet “diMAL”, pas mishit të infektuar, drogë në kontejner

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi



Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E
TRUPROJAVE/ Nga
tokat te klubet VIP:
Rrjoll, Zvërnec,
Sarandë e Ksamil
nën hijen e "burrave
të zinj"

Moti

Powered by tomorrow

"Fieri, Berati, Përmeti e Lushnja sa produkte të tyre hodhën në kanale? Sepse Ballkani i Hapur solli produktet e Serbisë, Maqedonisë se ato shtete e subvencionojnë fermerin, e forcojnë fshatarin. Ata të rinj që janë larguar nga fshati për të mbështetur familjet, dhe janë këtu në Tiranë, ata që kërkojnë revolucion.

Qumështi, sa litra u hodhën në kanalet e Lushnjes se oligarkët vendosën çmimin që të ishte aq i ulët sa fermeri s'e përballoi dot as prodhimin në 2024. Dhe kostoja e jetesës e jona në qytet rritet sepse është më mirë për këtë qeveri që të sjellë produktet nga jashtë dhe kjo është arsyeja se pse fermerët i kenë kudo dhe flasin me zemër për këtë protestë.", tha ajo.

4 ORE ME PARE


"O hajdut o kriminel"/ Protestuesit 'zënë mat' Taulant Ballën në kafe, socialisti ikën me telefon në vesh (VIDEO)



Taulant Balla

TIRANË- Gjatë ditës së 108-të të protestës kundër qeverisë dhe klasës politike, protestuesit kanë pikasur kreun e grupit të PS-së, Taulant Balla teksa qëndronte i ulur në ambientet e jashtme të një lokali pranë stadiumit "Air Albania" në Tiranë.

Siç shihet edhe në video, në momentin që qytetarët shohin Ballën të ulur, i drejtohet me thirrje në kor, "O hajdut!", "O kriminel!" dhe "O Taulant, o hajdut!".





Në video dëgjoen thirrjet e protestuesve, ndërsa Balla me një kapele dhe me telefon në vesh ngrihet nga tavolina dhe largohet nga ambienti i jashtëm i lokalit. Përballja me qytetarët vjen në një kohë kur protesta vijon prej 108 ditësh, me pjesëmarrësit që largimin e qeverisë Rama dhe gjithë klasës politike./Dosja.al

5 ORE ME PARE

Protesta e 108-të/ Mbyllen fjalimet përballë Kryeministrit, nis marshimi i qytetarëve në rrugët e Tiranës



Panjen nga marshimi

TIRANË- Protestuesit kanë mbyllur fjalimet përballë godinës së Kryeministrit, dhe kanë nisur marshimin drejt bulevardit Dëshmorët e Kombit.

Ata pritet të marshojnë në rrugët e kryeqytetit, ndërsa kanë bërë thirrje për një tubim përballë Kuvendit ditën e enjet. Kërkesat e qytetarëve mbeten të njetat, dorëheqja e panegociueshme e kryeministrit Edi Rama si dhe anulimin e ligjit për zonat e mbrojtura./Dosja.al

6 ORE ME PARE

FOTOLAJM/ Pankarta pikante nga protesta qytetare në Tiranë: Me ç'fytirë i ngjitesh pushtetit





Pankarta

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.